



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Drejtësisë/MinistarsvoPravde/Ministry of Justice

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm - Kancelarija Generalnog Sekretara - Office of the Secretary General

ZSP- Nr. 80
Datë: 25/06/2026

Në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare Nr.7/01 Mars 2019), duke u bazuar në nenin 65 paragrafit 1, 2, 3 dhe 4 të Ligjit Nr. 08/L -197 për Zyrtarët Publik, dhe në përputhje të paragrafit 4 të nenit 11 të Rregullores Nr.02/2024 për Transferimin e Nëpunësve Civil, Sekretari i përgjithshëm nxjerr këtë:

V E N D I M

për transferimin e përhershëm të nëpunësit civil për interes të institucionit

1. Z. Xhavit Sheqiri, nga pozita aktuale Zyrtar i Lartë Ligjor në Inspektoratin Qendror të Punës transferohet përhershëm brenda të njëjtës kategori profesionale të shërbimit civil për interes të institucionit në pozitën Zyrtar i Lartë për Mbikëqyrje në Divizionin për Mbikëqyrjen e Ligjshmërisë të Punës së Përmbarusve Privat, në Departamentin për Mbikëqyrjen e Ligjshmërisë të Punës së Profesionave të Lira në Ministrinë e Drejtësisë.
2. Obligohet Divizioni për Burime Njerëzore dhe Departamenti për Buxhet dhe Financa që të ndërmarr të gjitha veprimet për zbatimin e këtij vendimi dhe pagesën e nëpunësit sipas pagës së pozitës në të cilin është transferuar.
3. Vendimi hyn në fuqi me datën 01.07.2026.

A R S Y E T I M

Në zbatim të Rregullore ZKM-nr.10/2023 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Drejtësisë, për shkak të domosdoshmërisë së plotësimit të pozitës dhe në interes të institucionit, më datë 23.06.2026, është parashtruar kërkesa për transferimin e përhershëm të nëpunësit civil

Z.Xhavit Sheqiri, brenda kategorisë së njëjtë profesionale nga pozita Zyrtar i Lartë Ligjor në Inspektoratin Qendror të Punës në pozitën Zyrtar i Lartë për Mbikëqyrje në Divizionin për Mbikëqyrjen e Ligjshmërisë të Punës së Përmbarusve Privat, në Departamentin për Mbikëqyrjen e Ligjshmërisë të Punës së Profesioneve të Lira në Ministrinë e Drejtësisë.

Në mbështetje të nenit 65 (paragrafi 1,2,3,dh 4) të Ligjit nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik dhe nenit 11(paragrafi 4) të Rregullues nr.02/2024 për transferimin e nëpunësve civil, duke u bazuar në kërkesën e arsyetuar për këtë transferim, dhe pas marrjes së pëlqimit nga nëpunësi civil, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Ridvan Hoti

Sekretar i Përgjithshëm



Vendimi i'u dërgohet;

- Z.Xhavit Sheqiri;
- Kabinetit të Zëvendëskryeministres dhe Ministres së Drejtësisë në detyrë;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Departamentit për Mbikëqyrjen e Ligjshmërisë të Punës së Profesioneve të Lira;
- Departamentit për Buxhet dhe Financa;
- Divizionit për Burime Njerëzore;
- Inspektorit Qendror të Punës;
- Arkivit të Ministrisë së Drejtësisë.